



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 115

Datë 25 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 67/2014 datë 3.7.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar.....	5111
Ligj nr. 68/2014 datë 3.7.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar.....	5113
Ligj nr. 69/2014 datë 3.7.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësoar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Shëndetësia elektronike në Shqipëri – Regjistri Mbarëkombëtar i Shëndetësisë Elektronike”.....	5116
Vendim i KM nr. 496, datë 22.7.2014	Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim.....	5128
Udhëzim i MB, MAS, MPJ, MSH dhe MMSR nr. 3799, datë 8.7.2014	Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.....	5131
Vendim i BSH nr. 31, datë 30.4.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”.....	5132

LIGJ
Nr. 67/2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
LIGJIN NR. 10 186, DATË 5.11.2009, "PËR
RREGULLIMIN E PRONËSISË MBI TRUALLIN
SHTETËROR NË ZONAT ME PËRPARËSI
TURIZMIN", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 186, datë 5.11.2009, "Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2, pika 1, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronjat "c", "d" dhe "ë" ndryshohen si më poshtë:

"c) "Person i stimuluar" është personi fizik apo juridik, i cili ka përfituar titullin e personit të stimuluar, në përputhje me ligjin nr. 7665, datë 21.1.1993, "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", të shfuqizuar.

d) "Njësi e ndërtuar" është objekti ose tërësia e objekteve apo e apartamenteve, të ndërtuara brenda kufirit të zonës, për të cilën personi ka fituar titullin person i stimuluar.

ë) "Truall" është e gjithë sipërfaqja e tokës brenda zonës së stimuluar, sipas kufirit të lejes së miratuar të sheshit të ndërtimit."

2. Shkronja "f" shfuqizohet.

3. Pas shkronjës "g" shtohen shkronjat "gj", "h", "i" dhe "j" me këtë përmbajtje:

"gj) "Truall i lirë" është sipërfaqja e tokës, brenda zonës së simuluar, e përcaktuar nga plani i rilevimit, brenda kufirit të lejes së miratuar të sheshit të ndërtimit, i tillë si sheshe, troje funksionale, pishina, sipërfaqe të gjelbëruara, rrugë apo truall tjetër me destinacion dhe funksion të ngjashëm."

h) "Plan rilevimi" quhet plani i përgatitur nga ALUIZNI pas përditësimit në terren, ku paraqitet gjendja faktike e zonës së stimuluar, sipas kufijve të miratuar në lejen e sheshit.

i) "Objekt i ndërtuar" është objekti, për të cilin është përfunduar konstruksioni dhe mbulesa.

j) "Veprimtari joturistic në zonë me përparësi turizmin" janë ato veprimtari të dhëna në përputhje me shkronjën "b", të nenit 4, të ligjit nr. 7665, datë

21.1.1993, "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", të shfuqizuar."

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Ky ligj zbatohet për kalimin e së drejtës së pronësisë subjekteve të interesuara apo personave të stimuluar mbi njësitë e ndërtuara dhe truallin brenda zonës së stimuluar, si dhe për veprimtaritë joturistike në zonë me përparësi turizmin."

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Procedurat e këtij ligji do të zbatohen edhe për personat që ushtrojnë "veprimtari joturistic në zonë me përparësi turizmin."

Neni 3

Në nenin 4, pika 1, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) dokumentacionin që provon veprimin juridik ndërmjet personit të stimuluar dhe subjektit të interesuar për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi njësinë e ndërtuar."

Neni 4

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat "b", "c", "ç" dhe "e", të pikës 1, ndryshohen si më poshtë:

"b) marrëveshjen e qirasë apo të zhvillimit, të lidhur ndërmjet personit të stimuluar dhe qiradhënësit, nëse është lidhur një marrëveshje e tillë;

c) lejen e ndërtimit dhe/ose lejen e sheshit të ndërtimit;

ç) projektin arkitektonik të miratuar;

e) vërtetimin nga Agjencia Kombëtare e Turizmit për detyrimet e marrëveshjes së qirasë, të llogaritura deri në momentin e zgjidhjes së marrëveshjeve."

2. Pas shkronjës "e" shtohet shkronja "f" me këtë përmbajtje:

"f) vendimin e organeve kompetente për dhënien e titullit person i stimuluar."

3. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

"2. Pika 1 e këtij neni, do të zbatohet edhe për subjektet, të cilat kanë zhvilluar një veprimtari joturistic në zonë të stimuluar."

Neni 5

Pas nenit 7 shtohet neni 7/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 7/1

Procedura e kalimit të pronësisë mbi truallin

1. Nëse marrëveshja e qirasë ose e zhvillimit është e lidhur me personin e stimuluar në truall shtetëror, përpara datës së kthimit dhe kompensimit fizik nga

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ALUIZNI kalon pronësinë e truallit në favor të subjektit të interesuar apo personit të stimuluar.

2. Personat, të cilët preken nga zbatimi i pikës 1, të këtij neni, kompensohen në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.”.

Neni 6

Në nenin 8, pika 2 shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Subjekti i interesuar ose personi i stimuluar ka të drejtë të kërkojë blerjen e truallit në funksion të njësisë së ndërtuar, të ndodhur brenda kufirit të parcelës ndërtimore, të përcaktuar në planin e rilevimit, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë kre.”.

Neni 8

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Pronësia dhe bashkëpronësia mbi truallin e lirë

1. Në përfundim të procesit të përcaktuar në nenin 9, trualli që mbetet i lirë brenda kufijve të zonës së stimuluar, të përcaktuar nga plani i rilevimit, kalon në bashkëpronësi të detyrueshme dhe të patjetërsueshme në favor të subjekteve të interesuara dhe personit të stimuluar.

Afatet dhe procedurat e kalimit të bashkëpronësisë së detyrueshme mbi truallin e lirë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Mënyra administrimit dhe e rregullimit të bashkëpronësisë mbi këtë truall kryhet në përputhje me ligjin për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Në rast se subjektet e interesuara dhe personi i stimuluar nuk kërkojnë kalimin në bashkëpronësi të detyrueshme të truallit të lirë, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të këtij neni, ky truall mbetet me titull pronësie shtet.

3. Përjashtimisht nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni, personi i stimuluar, i cili ka përfunduar ndërtimin e njësisë, deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, dhe nuk e ka ndryshuar destinacionin e tyre për veprimtari të stimuluar, ka të drejtë të kërkojë blerjen e të gjithë truallit të lirë brenda zonës së stimuluar, bazuar në planin e rilevimit.

4. Në çdo rast, trualli i lirë brenda kufijve të zonës së stimuluar, pavarësisht nëse ka kaluar ose jo në pronësi, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, konsiderohet “zonë

e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”, në përputhje me ligjin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.”.

Neni 9

Në nenin 10, pikat 1 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Çmimi i truallit brenda zonës së stimuluar përcaktohet në bazë të hartës së vlerës së tokës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. ALUIZINI lidh kontratën e shitjes për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, sipas modelit tip, si dhe njofton me shkrim subjektin e interesuar ose personin e stimuluar që plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj dhe për masën e çmimit. Modeli tip i kontratës së shitjes miratohet me urdhër nga ministri përgjegjës brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 10

Në nenin 11, pika 3, shkronja “a” shfuqizohet.

Neni 11

Në nenin 14 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çmimi i truallit reduktohet në masën 10 për qind, nëse paguhet brenda 1 muaji nga njoftimi me shkrim, sipas pikës 3, të nenit 10, të këtij ligji.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë së truallit ndahen si më poshtë:

a) 80 për qind të vlerës në Buxhetin e Shtetit për fondin e kompensimit financiar të parashikuar nga ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;

b) 20 për qind të vlerës për llogari të ALUIZNI-t.

Të ardhurat e realizuara nga tarifat dhe tatimet administrohen sipas neneve 13 dhe 15 të këtij ligji.”.

Neni 12

Në nenin 15/1, fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Detyrimet e prapambetura llogariten nga Agjencia Kombëtare e Turizmit deri në momentin e zgjidhjes së marrëveshjes.”.

Neni 13

Në nenin 16 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Mospagimi i çmimit nga subjekti i interesuar ose personi i stimuluar, brenda 6 muajve nga njoftimi me

shkrim, sipas pikës 3, të nenit 10, të këtij ligji, sjell penalitete në masën 10 për qind të çmimit total të truallit për çdo muaj vonesë, me kusht që masa e penaltetit të mos kalojë çmimin total të truallit.”.

3. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Nëse personi i stimuluar ka kryer shtesa mbi lejen e ndërtimit, zbatohen penaltetet e parashikuara në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”.

Neni 14

Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Të gjitha njësitë e ndërtuara, të cilat janë në proces legalizimi, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do t'i nënshtrohen zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Subjektet e interesuara ose personat e stimuluar, të cilët kanë kryer pagesën e plotë të vlerës së truallit, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe nuk e kanë lidhur ende kontratën për kalimin së drejtës së pronësisë mbi truallin, përfundojnë procedurën e kalimit të së drejtës së pronësisë me lidhjen e kontratës, sipas modelit tip të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës, bazuar në dispozitat e këtij ligji.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendimin në zbatim të nenit 8, pika 1, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8640, datë 24.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 68/2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9587, DATË 20.7.2006, “PËR MBROJTJEN E BIODIVERSITETIT”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pas pikës 2 shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“3. Të sigurojë ngritjen e rrjetit për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Të përcaktojë masa për të mbajtur ose rivendosur në një status të favorshëm ruajtjeje habitatet natyrore dhe llojet e faunës së egër të Shqipërisë dhe me interes për Komunitetin Europian.

5. Të sigurojë që masat e ndërmarra, në zbatim të këtij ligji, të marrin në konsideratë kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore, si dhe karakteristikat rajonale.”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 12, 35 dhe 36 ndryshohen si më poshtë:

“12. Leje mjedisi” janë përkatësisht lejet e mjedisit të tipit A, B ose C, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

35. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

Nenin 2 (pikat 2 dhe 3), nenin 3 (pikat 1 dhe 2), nenin 4 (pika 1), nenin 6 (pika 2), nenin 11, nenin 12 (pika 4), nenin 14 (pika 1) dhe nenin 17 (pika 1) të Direktivës së Këshillit 92/43/KEE “Për ruajtjen e habitateve natyrore, të faunës dhe florës së egër” (Numri CELEX: 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L nr. 206, datë 22.7.1992, faqe 7–50), e amenduar nga Direktiva e Këshillit 97/62/KE, datë 27 tetor 1997, Rregullorja e Parlamentit Europian dhe e Këshillit (KE) nr. 1882/2003, datë 29 shtator 2003, Direktiva e Këshillit 2006/105/KE, datë 20 nëntor 2006 dhe Direktiva e Këshillit 2013/17/BE, datë 13 maj 2013.

36. “Ministër” është ministri përgjegjës për mjedisin.”.

2. Pika 37 shfuqizohet.

3. Pas pikës 42 shtohen pikat 43, 44, 45, 46 dhe 47 me këtë përmbajtje:

“43. “Njësitë e qeverisjes vendore” kanë të njëjtin kuptim të dhënë sipas ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

44. “Natura 2000” është rrjeti ekologjik i zonave të mbrojtura, i ngritur për të siguruar mbijetesën e habitateve dhe llojeve më me vlerë të Europës.

45. “Zona me interes për komunitetin” është zona, e cila, në rajonet biogeografike ose në rajonet të cilave u përket, kontribuon dukshëm në ruajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të një tipi habitati natyror ose lloji, që mund të kontribuojë dukshëm në lidhje me rrjetin “Natura 2000”, dhe/ose kontribuon dukshëm në ruajtjen e diversitetit biologjik brenda rajonit biogeografik ose rajoneve në fjalë.

46. “Zonë e veçantë ruajtjeje” ka të njëjtin kuptim të dhënë sipas ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar.

47. “Zonë veçanërisht e mbrojtur” është zona ku shpendët e egër klasifikohen si të rrallë e të cenueshëm (vulnerabël) dhe, si rregull, u përkasin llojeve migratore që janë strikte të mbrojtura.”.

Neni 3

Në nenin 3, pika 1, shkronja “a”, pas fjalëve “pronë shtetërore apo private” shtohen fjalët “veçanërisht në rrjetin përfaqësues të zonave të mbrojtura të Shqipërisë”.

Neni 4

Titulli i nenit 5, “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” ndryshohet si më poshtë:

“Ministria përgjegjëse për mjedisin”.

Neni 5

Në nenin 16 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “hartojnë planet e menaxhimit” shtohen fjalët “dhe planet e veprimit”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Kriteret minimale për planet e menaxhimit të ekosistemeve, habitateve dhe që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 6

Pas kreut IV shtohet kreu IV/I, “Menaxhimi dhe mbrojtja e tipave të habitateve natyrore, kafshëve, përfshirë shpendët e egër, si dhe llojet e bimëve me interes për komunitetin”, me këtë përmbajtje:

5114

“KREU IV/I

MENAXHIMI DHE MBROJTJA E TIPAVE TË HABITATEVE NATYRORE, KAFSHËVE, PËRFSHIRË SHPENDËT E EGËR, SI DHE LLOJET E BIMËVE ME INTERES PËR KOMUNITETIN

Neni 17/1

Ruajtja e habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve

1. Zona të veçanta të ruajtjes, të cilat përfshijnë zonat me habitat natyror, habitatet e llojeve dhe zonat e veçanta të mbrojtura për shpendët e egër, që do të kontribuojnë në krijimin e rrjetit ekologjik koherent europian, përveç atyre të parashikuara në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura” të ndryshuar, përcaktohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17/4, shkronjat “a”, “b” dhe “d”, të këtij ligji.

2. Rrjeti ekologjik bashkëkohor “Natura 2000” i zonave të veçanta të ruajtjes dhe zonave të veçanta të mbrojtura ngrihet në bazë të dispozitave të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të këtij ligji.

Neni 17/2

Përcaktimi dhe menaxhimi i habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve

1. Ministria përzgjedh një listë të zonave me interes për komunitetin, duke identifikuar dukuritë e tipave të habitateve dhe llojet, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 17/4, të këtij ligji, në çdo rajon përkatës biogeografik, me qëllim propozimin Komisionit Europian të listës së zonave, të cilat strehojnë këta tipa habitatesh dhe llojesh. Lista kombëtare e zonave me interes për komunitetin, së bashku me një përshkrim të tipareve karakteristike të zonave specifike, përgatitet në përputhje me dokumentacionin dhe kërkesat e përcaktuara për çdo zonë, sipas shtojcës 1, të vendimit nr. 897, datë 21.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes”.

2. Ministria mbikëqyr statusin e ruajtjes së habitateve natyrore dhe të llojeve, referuar në shkronjën “c”, të nenit 17/4, duke i kushtuar vëmendje të veçantë habitateve natyrore prioritare, llojeve prioritare, si dhe nxit kërkimet e punën shkencore, me qëllim arritjen e objektivave.

3. Ministria krijon sistemin e monitorimit për kapjen e rastësishme dhe vrasjen e llojeve, referuar në shkronjën “c”, të nenit 17/4, kryen kërkime të mëtejshme ose merr masa për ruajtjen siç kërkohet, duke shmangur ndikimin negativ të dukshëm për llojet në fjalë.

4. Masat, përfshirë mbikëqyrjen e vazhdueshme, për të siguruar që marrja në gjendje të egër dhe/ose shfrytëzimi i llojeve, referuar në shkronjën “ç”, të nenit 17/4, të jetë

objekt i masave menaxhuese dhe në përputhje me mbajtjen e statusit të favorshëm të ruajtjes së tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Lista e zonave të veçanta të mbrojtura, duke identifikuar zonat përkatëse, për të siguruar mbrojtjen e llojeve kombëtare, në përputhje me shkronjën “d”, të nenit 17/4, të këtij ligji, përcaktohet me urdhër të ministrit.

Neni 17/3 Masat shoqëruese

Ministria:

a) merr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të shmangur dëmtimin dhe/ose shqetësimin e habitateve natyrore, habitateve të llojeve në zonat e veçanta të ruajtjes, si dhe të shpendëve të egër në zonat e veçanta të ruajtjes;

b) harton marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë organizatat jofitimprurëse, për të siguruar zbatimin efektiv të këtij kreu;

c) siguron që informacioni i transmetuar nga njësitë e qeverisjes vendore për statusin e ruajtjes së natyrës të shqyrtohet në mënyrën e duhur;

ç) siguron që procedurat për përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes të jenë të thjeshta dhe të shpejta, me qëllim nxitjen e krijimit të zonave të mbrojtura;

d) siguron, në përputhje me legjislacionin në fuqi, se çdo palë e përfshirë në çështjet për natyrën të kontribuojë në ruajtjen dhe rivendosjen e statusit, duke kryer, sipas rastit, edhe procedurat ligjore për kompesim për shkaktim dëmi.

Neni 17/4

Listat e llojeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton:

a) listën e llojeve të habitateve natyrore me interes për komunitetin, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;

b) listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për komunitetin, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;

c) listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për komunitetin në nevojë për mbrojtje strikte;

ç) listën e llojeve të bimëve dhe kafshëve me interes për komunitetin, marrja e të cilave në gjendje të egër dhe shfrytëzimi mund të jetë objekt i masave menaxhuese;

d) parimet e identifikimit të llojeve që do të jenë objekt kërkimesh për mbrojtjen dhe menaxhimin e shpendëve të egër.

Neni 17/5 Raportimi

1. Në kuadër të rrjetit ekologjik “Natura 2000”, ministria përgatit, në çdo 6 vjet, raportin për zbatimin e masave të marra, sipas dispozitave të këtij kreu. Ky raport përfshin veçanërisht masat ruajtëse, referuar në nenet 17/2 dhe 17/3, të këtij ligji, një vlerësim të ndikimit të tyre për ruajtjen e statusit të llojeve të habitateve natyrore, të përmendura në shkronjën “a”, dhe të llojeve të bimëve e kafshëve, sipas shkronjës “b”, të nenit 17/4, si dhe rezultatet kryesore të mbikëqyrjes, referuar në pikën 4, të nenit 17/2. Ky raport bëhet i disponueshëm për publikun.

2. Formatimi që do të përdoret për hartimin e raportit, përcaktohet me urdhër të ministrit.”.

Neni 7

Në nenin 26, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kriteret minimale për planet e menaxhimit të habitateve të llojeve veçanërisht të mbrojtura përcaktohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 8

Kudo në ligj emërtimi “Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.

Neni 9

Dispozitë kalimtare, aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6 të tij.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 5, 6 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 10 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miruar në datën 3.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8641, datë 24.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 69/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE I
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA
AG PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“SHËNDETËSIA ELEKTRONIKE NË SHQIPËRI -
REGJISTRI MBARËKOMBËTAR I
SHËNDETËSISË ELEKTRONIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe i përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit “Shëndetësia elektronike në Shqipëri - Regjistri Mbarëkombëtar i Shëndetësisë Elektronike”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8642, datë 24.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE KREDIE EKSPORTI

HUA E BUTË NR. 232,324

**PËR NJË SHUMË MAKSIMALE PREJ 13.995.000
EUROSH**

**(PËR FAZËN I 7.483.000 EURO DHE PËR FAZËN
II 6.512.000 EUROSH)**

DATË2013

**LIDHUR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË
EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE
(SI “HUAMARRËS”) DHE UNICREDIT BANK
AUSTRIA AG (SI “HUADHËNËS”) NË LIDHJE ME
FINANCIMIN E PROJEKTIT “SHËNDETËSIA
ELEKTRONIKE SHQIPËRI - REGJISTRI
MBARËKOMBËTAR I SHËNDETËSISË
ELEKTRONIKE”**

Kjo Marrëveshje kredie eksporti për një hua të butë nr. 232,324, për një shumë maksimale prej 13.995.000 eurosh (“Marrëveshja”) është e datës 2013, e lidhur ndërmjet Huamarrësit, të specifikuar në aneksin 1 (“Huamarrësi”) dhe Huadhënësit (“Huadhënësi”) të specifikuar në aneksin 1.

1. PËRKUFIZIMET

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme: -

“Datë e Pranimit” është data në të cilën kjo Marrëveshje nënshkruhet nga të dyja palët dhe ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

“Aneks” është një aneks në këtë Marrëveshje termat e të cilit konsiderohen të jenë përfshira në këtë Marrëveshje dhe përbëjnë pjesë të saj.

“Periudhë e Disponueshmërisë” janë afatet e specifikuara në aneksin 3 gjatë të cilave Huamarrjet mund të tërhiqen nga Shuma e Kredisë.

“Huamarrje” është një shumë e tërhequr nga Huamarrësi nga Shuma e Kredisë.

“Ditë Pune” është një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë dhe transaksionet dhe depozitat në monedhë të huaj ndërmjet bankave mund të kryhen në Vjenë dhe në Tiranë.

“Data e Mbylljes” është data e përcaktuar në seksionin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

“Shuma e Kredisë” është shuma e specifikuar në aneksin 3 kundrejt së cilës Huamarrësi mund të tërheqë Huamarrjet gjatë Periudhës së Disponueshmërisë.

“Euro” ose “€”, monedha e vetme e atyre shteteve anëtare të Bashkimit Europian që miratojnë euron si monedhë të tyre në pajtim me legjislacionin e Komunitetit Europian në lidhje me Bashkimin Europian Ekonomik dhe Monetar.

“EURIBOR” është norma e përqindjes në vit, e barabartë me vlerën aktuale mbi bazën e marrëveshjes

365/360 të mesatares së normës së depozitave të EURIBOR-it të miratuara me EURIBOR FBE (faqe 248) për një periudhë të barabartë me periudhën për të cilën interesi duhet të caktohet nga Huadhënësi (seksioni 3.3), në ose rreth orës 11:00 në Bruksel në Ditën e dytë të Punës para fillimit të Periudhës përkatëse të Interesit. Në këtë kontekst, “FBE” do të thotë “Federation Bancaire Europeenne”.

“Proces Vlerësimi” do të thotë procesi i vlerësimit që duhet të kryhet nga OeKB-ja sipas aneksit M të Marrëveshjes së Blerjes dhe sipas specifikimit në Garancinë e OeKB-së, në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e fazës I të Projektit.

“Llogari e Huas” është llogaria e hapur në emër të Huamarrësit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.3.

“Data të Pagesës së Interesit” është 31 marsi, 30 qershori, 30 shtatori dhe 31 dhjetori i çdo viti, me kusht që nëse një nga këto data nuk është Ditë Pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës më të afërt pararendëse të punës.

“Periudhë Interesi” është një periudhë që:

i) fillon në datën e Huamarrjes ose në ditën e fundit të periudhës së saj të mëparshme të interesit; dhe

ii) mbaron më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator ose 31 dhjetor në çdo vit.

“Barrë” është çdo hipotekë, tarifë, peng, barrë, hipotekim, detyrim, ruajtje titulli ose çdo interes tjetër garancie të çdo lloji dhe që ka lindur në çdo lloj mënyre.

“Hua” është shuma e përgjithshme e principalit të Huamarrjeve të tërhequra sipas Shumës së Kredisë dhe ende të papaguara.

“Datat e Shlyerjes së Detyrueshme” nënkupton datat në çdo vit, të përcaktuara në aneksin 3, me kusht që nëse një nga këto data nuk është ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj Ditës më të afërt pararendëse të Punës.

“OeKB” është Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, 1011 Vienna, Austria, që vepron si Agjenci Kredie Eksporti për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

“Garanci e OeKB-së” është një Garanci e lëshuar nga OeKB-ja si agjente e Republikës së Austrisë.

“Procedurë Paguese” është procedura për pagesën e Huamarrjeve të përcaktuara në aneksin 4.

“Faza I” është faza e parë e Projektit sipas përcaktimit në aneksin 2.

“Faza II” është faza e dytë e Projektit sipas përcaktimit në aneksin 2.

“Projekt” është Projekt i përcaktuar në aneksin 2.

“Blerës i Projektit” është blerësi i projektit i përcaktuar në aneksin 2.

“Eksportues i Projektit” është eksportuesi austriak i përcaktuar në aneksin 2.

“Datë e Pranimit të Përkohshëm” është data në të cilën Huadhënësi ka marrë nga Eksportuesi i Projektit një kopje të COHO (sipas përkufizimit në Marrëveshjen e Blerjes);

“Marrëveshje e Blerjes” është marrëveshja në lidhje me Projektin e lidhur ndërmjet Eksportuesit të Projektit dhe Blerësit të Projektit dhe e përcaktuar në aneksin 2.

“Seksion” është një seksion i kësaj Marrëveshjeje.

2. SHUMA E KREDISË

2.1 Hyrje

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i termave dhe i kushteve sipas të cilave Huadhënësi do të financojë 100% të vlerës së përgjithshme të kontratës (por deri në një shumë maksimale të specifikuar si “Shuma e Kredisë” në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje) që duhet të paguhet nga Blerësi i Projektit për Eksportuesin e Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

2.2 Shuma e Kredisë

i) Huadhënësi bie dakord t’i vërë në dispozicion Huamarrësit Shumën e Kredisë gjatë Periudhës së Disponueshmërisë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, me kusht që një Huamarrje mund të bëhet nga Huamarrësi sipas Shumës të Kredisë në pajtim me Procedurën e Pagesës së përcaktuar në aneksin 4 dhe zbatohet kundrejt pagesës së çmimit të kërkueshëm ndaj Eksportuesit të Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes.

ii) Huamarrësi bie dakord shprehimisht që Huamarrja e parë sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë parapagesa në shumën prej 15% të shumës së përgjithshme të Marrëveshjes së Blerjes (sipas përcaktimit në aneksin 4), pavarësisht faktit që Projekti mund të përfundojë pas përfundimit të fazës I për shkak të një rezultati negativ të Procesit të Vlerësimit.

Për më tepër, Huamarrësi bie dakord shprehimisht për mekanizmin e pagesës gjatë fazës I dhe fazës II sipas përcaktimit në aneksin 4.

iii) Kuptohet që në fund të fazës I, shuma e përgjithshme e disbursuar prej 7.483.000 eurosh do të jetë e barabartë me vlerën e të gjitha dorëzimeve që Eksportuesi i Projektit duhet të bëjë gjatë fazës I, pavarësisht nga pagesa fillestare e pagesës paraprake në shumën prej 15% të vlerës së përgjithshme të Projektit, për shkak të faktit që, të gjitha disbursimet do të kreditohen kundrejt vlerës së dorëzimeve gjatë fazës I (duke përfshirë një kompensim kundrejt shumave të paguara si parapagesë për fazën II) dhe Huadhënësi nuk do të paguajë asnjë shumë që kalon 7.483.000 euro - pavarësisht vlerës së përgjithshme aktuale të dokumenteve të paraqitura gjatë fazës I (sipas përcaktimit në aneksin 4).

iv) Kredia e dhënë jepet sipas dhe në përputhje me dispozitat e rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë.

Huamarrësi nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje thekson që financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element granti prej 35,30 % (tridhjetë e pesë pike tridhjetë për qind).

v) Huadhënësi mund të refuzojë disbursimin e një Huamarrjeje nëse kjo Huamarrje dhe interesi mbi të nuk do të mbulohej nga garancia e dhënë nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë në pajtim me Aktin e Promovimit të Eksportit, i ndryshuar, dhe/ose marrëveshja e financimit me OeKB-në për Shumën e Kredisë pushon së qeni në fuqi.

2.3 Llogaria e Huas

Huadhënësi hap një llogari në euro në emrin e Huamarrësit, të përcaktuar si "Llogaria e Huas". Çdo Huamarrje e bërë sipas kësaj Marrëveshjeje debitohet në Llogarinë e Huas, në pajtim me këtë Marrëveshje, me vlerë në datën e pagesës së kësaj Huamarrjeje. Shlyerjet dhe parapagimet aplikohen përkatësisht në Llogarinë e Huas.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe Marrëveshjes së Blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e Blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë dështim i Eksportuesit të Projektit në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Blerjes nuk ndikon të detyrimet e Huamarrësit ndaj Huadhënësit, as nuk e bën Huadhënësin përgjegjës për dështimin e Eksportuesit të Projektit dhe/ose të ndonjë pale tjetër të Marrëveshjes së Blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi për llogarinë e Huas

Huamarrësi paguan interesin në Datat e Pagesës së Interesit me një normë fikse, sipas përcaktimit në aneksin 3, të llogaritur mbi shumën e papaguar të kredisë.

3.2 Llogaritja dhe Data për Pagesën e Interesit

Interesi i kërkueshëm, në pajtim me seksionin 3.1, i grumbulluar ditë pas dite, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara për periudhën përkatëse të interesit dhe një viti me 360 ditë, dhe, përveç sa parashikohet në seksionin 6.1, do të paguhet në fund të çdo tremujori nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rast të pamundësisë së Huamarrësit për të kryer në datën e duhur pagesën e çdo shume të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë interes mbi këtë shumë nga data e kësaj mospagese deri në datën e pagesës aktuale në normën e caktuar në aneksin 3. Kamatëvonesa sipas këtij seksioni 3.3 do të jetë e kërkueshme në Datat e Pagesës së Interesit.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifa e angazhimit

Për periudhën që fillon në Datën e Mbylljes dhe që mbaron në fund të Periudhës së Disponueshmërisë,

Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë angazhimi në normën e caktuar në aneksin 3. Tarifa e angazhimit e kërkueshme në pajtim me këtë seksion 4.1 llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të Shumës së Kredisë në fillim të çdo tremujori kalendarik dhe paguhet në fund të çdo periudhe nga Huamarrësi Huadhënësit në Datat e Pagesës së Interesit. Pagesa e parë e tarifës së angazhimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në Datën e parë të Pagesës së Interesit pas Datës së Mbylljes.

4.2 Tarifa e menaxhimit

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditë Pune para disbursimit të parë të Shumës të Kredisë) do t'i paguajë Huadhënësit tarifën e menaxhimit të përcaktuar në aneksin 3.

4.3 Shpenzimet

i) Huamarrësi i paguan më tej Huadhënësit, me kërkesë, shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (përfshirë shpenzimet ligjore, të përkthimit dhe udhëtimit dhe shpenzimet mbi garancinë e OeKB-së), të bëra nga Huadhënësi në lidhje me padinë për kompensim të çdo shume të kërkueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje.

ii) Të gjitha taksat, tatimet, shpenzimet ose detyrimet e tjera të vendosura për Huadhënësin nga Ministria e Financave, Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë për llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin.

4.4 Primi i Garancisë

Sipas Marrëveshjes, Huadhënësi i faturon Huamarrësit një kompensim për primin e Garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

i) Primi i Garancisë së OeKB-së dhe tarifa e administrimit të OeKB-së e pagueshme në fillim

Huamarrësi, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Datës së Mbylljes (por jo më vonë se 5 Ditë Pune para disbursimit të parë të Shumës së Kredisë) do t'i paguajë Huadhënësit një pjesë fillestare të kompensimit për primin e garancisë të OeKB-së dhe tarifën e administrimit të përcaktuar në aneksin 3 në shumat e përcaktuara në aneksin 3.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh

Duke filluar nga Data e Pagesës së Interesit që është pas Datës së Mbylljes, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë së OeKB-së, të pagueshëm si marzh, të përcaktuar në aneksin 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së është i kërkueshëm dhe i pagueshëm çdo tre muaj në Datat e Pagesës së Interesit.

Grafiku i pagesës së shumave që duhet të paguhet sipas seksionit 4.4 do të përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-ja. Huadhënësi do të informojë Huamarrësin përkatësisht për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës dhe ky njoftim bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit, primi i Garancisë së OeKB-së rritet për shkak se: i) vlerësimi i riskut tregtar të bërë nga OeKB-ja në lidhje me lëshimin e Garancisë së OeKB-së ka ndryshuar; ose ii) ndryshimet thelbësore në kushtet kontraktuale të Marrëveshjes së Kredisë së Eksportit janë miratuar, Huamarrësi rimbursion Huadhënësin për këtë rritje sipas kërkesës.

Nëse Marrëveshja e Blerjes zgjidhet pas përfundimit të fazës I për shkak të një rezultati negativ të Procesit të Vlerësimit, primi i garancisë dhe granti shtesë i përmendur në aneksin 3, neni 7 (ii) do të përshtatet nga OeKB-ja sipas rrethanave.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e detyrueshme

Huaja e papaguar në fund të Periudhës së Disponueshmërisë do të shlyhet nga Huamarrësi në një numër të barabartë këstesh gjashtëmujore shlyerjeje në Datat e Shlyerjes së Detyrueshme, të përcaktuara në aneksin 3. Huadhënësi, brenda 15 ditëve kalendarike pas Datës së Pranimit të Përkohshëm, do të njoftojë Huamarrësin për listën e Datave të Shlyerjes së Detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në secilën prej këtyre datave.

5.2 Parapagimi opsional

Huamarrësi mund të parapaguajë Huan plotësisht ose pjesërisht (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në aneksin 3 ose shumëfishat integralë të saj) pas dhënies së një njoftimi me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë kalendarike para (ky njoftim është i pakthyeshem) datës së propozuar të parapagimit për Huadhënësin në bazë të aprovimit të OeKB-së dhe pagesave të çdo kostoje ekuivalente me humbjen e llogaritur të shkaktuara nga Huadhënësi. Çdo parapagesë e tillë, nëse bëhet gjatë Periudhës së Disponueshmërisë, do të zvogëlojë vlerën e Shumës së Kredisë me një vlerë të barabartë me këtë parapagesë. Çdo referencë ndaj Shumës së Kredisë në këtë Marrëveshje më pas konsiderohet të jetë referencë ndaj shumës së caktuar në aneksin 3, të reduktuar. Nëse kryhet pas mbarimit të Periudhës së Disponueshmërisë, çdo parapagim i tillë do të aplikohet për të reduktuar me shuma të barabarta këstet e shlyerjes së kërkueshme në një kohë të mëvonshme.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike para çdo Date të Pagesës së Interesit, sipas rastit, Datës së Shlyerjes së Detyrueshme, Huadhënësi do të njoftojë

Huamarrësin në lidhje me ato shuma që duhet të paguhet nga Huamarrësi për Huadhënësin në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e angazhimit, me kusht që pamundësia për dhënien e këtij njoftimi të mos lehtësojë Huamarrësin nga detyrimi i tij për të kryer pagesa të këtyre shumave të lartpërmendura, kur bëhen të kërkueshme.

Njoftimi përcakton, gjithashtu, për secilën pagesë që duhet të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (ndarja e shumave të kërkueshme dhe të pagueshme të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi kryen pagesën në mënyrën e sugjeruar dhe konfirmon me shkrim aplikimin e fondeve. Huamarrësi këshillon Huadhënësin me shkrim për qëllimin e pagesës (ndarja e fondeve) për çdo shumë të paguar nga Huadhënësi. Nëse nuk merret ndonjë informacion i tillë, zbatohet seksioni 6.6

Nëse një shumë e caktuar debitohet dhe/ose kreditohet në Llogarinë e Huas dhe/ose në ndonjë llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike para Datës së Pagesës së Interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me këtë Datë të Pagesës së Interesit do të mbartet dhe do të bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm ndaj Huadhënësit në Datën e ardhshme pasuese të Pagesës së Interesit, përkatësisht do të (në rastin e shumave të kredituara) rillogaritet në Datën e ardhshme pasuese të Pagesës së Interesit.

6.2 Mënyra e pagesës

Në çdo Datë të Pagesës së Interesit, Datë të Shlyerjes së Detyrueshme ose në çdo datë tjetër të kërkueshme për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumave dhe monedhës së kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, në vlerë në datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat e shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi për Huadhënësin do të bëhen në Vjenë në eurosh lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

6.3 Heqja dorë nga kompensimi ose kundërpadia

Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë kompensimi ose kundërpadie, që mund të ketë në lidhje me çdo shumë të detyrueshme kundrejt Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesë, për çfarëdolloj arsyeje, të ndonjë shume të kërkueshme për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të mbajë pagesa të shumave të detyrueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje mbi bazën e një padie, të drejte padie, të drejte të ligjshme ose kërkesë kundër Eksportuesit të Projektit ose furnizuesve të tjerë në lidhje me Projektin.

6.4 Pagesat të lira nga mbajtja e taksave dhe detyrime të tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen pa kompensim ose kundërpadi dhe do të jenë të lira dhe pa zbritje për ose në llogari të çdo takse, tatimi, shume të zbritur ose të mbajtur ose tarifa të tjera të tashme ose të ardhshme të çdo lloj natyre të Republikës së Shqipërisë, nëse Huamarrësit nuk i kërkohet me ligj ta bëjë këtë zbritje. Nëse kërkohet me ligj, shuma e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë do të rritet në masën e nevojshme për të garantuar që pas kësaj zbritjeje të taksave, tatimeve, shumave të zbitura, të mbajtura ose tarifave të tjera, Huadhënësi të marrë në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse kjo zbritje e taksave, tatimeve, shumave të zbitura, të mbajtura ose tarifave të tjera nuk do të ishte kërkuar. Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit fatura, vërtetime ose dëshmi të tjera që provojnë shumat (nëse ka) e paguara ose të pagueshme në lidhje me çdo shumë të lartpërmendur të zbitur ose të mbajtur.

6.5 Kostot e rritura

Nëse rezultati i:

- një ndryshimi në, ose prezantimit të një ligji, rregulloreje ose kërkese rregullatore ose një ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e tyre; ose

- përmbushjes nga Huadhënësi të çdo udhëzimi, kërkese ose detyrimi (pavarësisht nëse e ka fuqinë e ligjit apo jo) të ndonjë banke qendrore, autoriteti monetar, rregullator ose autoriteti tjetër;

(duke përfshirë, në çdo rast, pa kufizim, ato që lidhen me përshtatshmërinë e kapitalit, likuiditetin, asetet rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

a) të rrisë koston ose të vendosë kosto shtesë për Huadhënësin për vënien ose ruajtjen në dispozicion të angazhimit të tij ose ruajtjen ose financimin e Huas; dhe/ose

b) të reduktojë shumën e pagueshme ose kthimin real për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

c) të reduktojë normën e kthimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohet për të alokuar burimet e kapitalit për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

d) të kërkojë Huadhënësit të kryejë një pagesë ose të heqë dorë nga një kthim mbi, ose të llogaritur ndaj çdo shume të arkëtuar ose të arkëtueshme nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje,

atëherë Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit sipas kërkesës çdo kosto të tillë, ulje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim.

Çdo vërtetim i Huadhënësit në lidhje me këtë kosto, ulje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim, në mungesë të

një gabimi të dukshëm, do të jetë provë përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllimet e kësaj dispozite, Huadhënësi mund, në mirëbesim, të alokojë ose të shpërndajë kostot dhe/ose humbjet mes aseteve dhe detyrimeve të tij (ose ndonjë kategorie të tyre) mbi bazën që e konsideron të përshtatshme.

6.6 Ndarja e pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi prej Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje (përveç kur Huadhënësi ndryshon urdhrin e zbatimit) do të zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje në rendin e mëposhtëm, dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave në këtë rend (dhe për çdo ndryshim të tyre nga Huadhënësi):

a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 (Tarifa e Menaxhimit dhe Shpenzimet);

b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.3 (Primi i Garancisë së OeKB-së);

c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (Tarifa e Angazhimit);

d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (Kamatëvonesa);

e) shumat e prapambetura sipas seksionit 3.1 (Interesi);

f) shumat e prapambetura sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);

g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (Interesi);

h) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (Shlyerja e Detyrueshme);

i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (Parapagimi Opsional).

Huadhënësi do të informojë Huamarrësin në lidhje me çdo aplikim të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën i dhënë Huamarrësit nuk merret në konsideratë.

Huamarrësi pranon që në bazë të Garancisë që OeKB-ja ka rezervuar kundrejt Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar ndarjen e pagesave të përcaktuara më sipër. Në një rast të tillë Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi do të pranojë caktimin e OeKB-së dhe do të marrë përsipër të shlyejë Huan dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje të njoftuar në atë kohë (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme) nga Huadhënësi për Huamarrësin.

7. KUSHTET PARAPRAKE

Kjo Shumë Kredie do të vihet në dispozicion për Huamarrësin në datën ("Data e Mbylljes") kur Huamarrësi njoftohet nga Huadhënësi se kushtet e mëposhtme janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

i) Huadhënësi do të këtë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së Blerjes të pranueshme në formë dhe të pranueshme për Huadhënësin së bashku me një vërtetim nga Eksportuesi i Projektit në një datë jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike para Datës së Mbylljes, me efektin që Marrëveshja e Blerjes në formën e paraqitur Huadhënësit është në fuqi dhe efekt të plotë (aneksi 6);

b) një opinion të Ministrisë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë të pranueshëm për Huadhënësin me atë përmbajtje që Huadhënësi mund të kërkojë (sipas aneksit 5), së bashku me kopje të certifikuara të çdo miratimi ose autorizimi të përmendur në këtë opinion;

c) një kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që miraton në parim këtë Marrëveshje;

d) një plotfuqi të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të caktuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera, të cilat duhet të nënshkruhen dhe/ose dërgohen në lidhje me këtë Marrëveshje;

e) një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje të nënshkruar sipas rregullave nga një person ose persona të autorizuar me plotfuqinë e përmendur në paragrafin (d) më sipër;

f) modele firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit;

g) modele firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Blerësit të Projektit;

h) një emërim të një personi kontakti për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (aneksi 7);

i) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që Huadhënësi mund të kërkojë, me qëllim që të bëjë këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara nën të, një marrëveshje ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

ii) Huadhënësi do të këtë marrë:

a) garancinë e lëshuar nga OeKB-ja për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në pajtim me ligjin e promovimit të eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e të cilit mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) një marrëveshje rifinancimi me OeKB-në për Huan;

c) një marrëveshje plotësuese me Eksportuesin e Projektit dhe miratimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet e Huadhënësit.

iii) Çdo kusht plotësues (nëse ka) të kërkuar në garancinë e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB-ja.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk do të jenë përmbushur brenda Periudhës së Mbylljes, të përcaktuar në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas seksionit 4.2, kjo Marrëveshje nuk do të jetë më detyruese për palët.

Secili prej këtyre dokumenteve dhe njoftimeve do të jetë në gjuhën angleze ose gjermane. Nëse nuk është në gjuhën angleze ose gjermane, një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze i bashkëlidhet dokumentit të lartpërmendur.

8. RASTET E MOSPLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE

8.1 Rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Secili prej rasteve të mëposhtme përbën një rast të mosplotësimit të detyrimeve:

a) ka pamundësi pagese nga Huamarrësi, për më shumë se katërmëdhjetë (14) ditë kalendarike, të ndonjë principali, interesi ose shume tjetër të kërkueshme në lidhje me Huan; ose

b) Huamarrësi është i paafitë për të përmbushur ose respektuar, siç duhet kushte ose angazhime në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, të ndryshme nga pagesa e principalit, interesi ose shuma të tjera për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data më e hershme në të cilën Huamarrësi vihet në dijeni të pamundësisë së pagesës dhe data në të cilën njoftimi me shkrim për këtë pamundësi që kërkon nga Huamarrësi rregullimin e kësaj pamundësie, i është dhënë më parë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose angazhim të ndërmarrë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje do të rezultojë të ketë qenë e pasaktë në aspekte materiale në kohën kur është ndërmarrë; ose

d) Huamarrësi do të jetë në mosplotësim të pagesës ose përmbushjes së një detyrimi në lidhje me paratë e marra hua të ndryshme nga Huaja (duke përfshirë në çdo rast një detyrim sipas një garancie); ose

e) çdo autorizim, pëlqim, regjistrim ose aprovim (zyrtar apo tjetër) të kërkuara për vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose Huaje ose ekzekutimi i të cilave është tërhequr ose për ndonjë arsye pushon së qeni në fuqi dhe efekt të plotë; ose

f) Republika e Shqipërisë shpall një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e pagesës ndaj kreditorëve të saj; ose

g) çdo rast që ka, në diskrecionin e arsyeshëm të Huadhënësit, ndikim negativ material në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

h) garancia e Republikës së Austrisë e lëshuar nga OeKB-ja ose ndonjë prej dispozitave të saj është

anuluar, ka përfunduar ose ka pushuar së qeni në fuqi dhe efekt ose ka pushuar së dhëni garancinë e synuar ose bëhet e paligjshme ose shpallet e pavlefshme për arsye, raste ose rrethana që mund t'i atribuohen sferës së Huamarrësit.

8.2 Masat për rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Nëse ka ndodhur një rast i mosplotësimit të detyrimeve dhe në çdo kohë më pas, të gjitha masat e mëposhtme që mund të merren nga Huadhënësi do të jenë të vazhdueshme:

a) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë principalin dhe interesin e shtuar në lidhje me Huan dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, si menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pas së cilit do të bëhen menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pa deklaram, kërkesë, kundërshtim ose njoftim tjetër të çdo lloji;

b) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë të përfunduar Shumën e Kredisë, pas të cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe vazhduar Huan sipas kësaj Marrëveshjeje, do të përfundojë menjëherë; dhe

c) çdo masë tjetër që Huadhënësi mund të vendosë të marrë, sipas diskrecionit të tij absolut.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi mund të ketë si pasojë e mosplotësimit të detyrimeve (duke përfshirë por pa u kufizuar në ndonjë interes të paguar nga Huadhënësi për huadhënësit e fondeve të marra hua nga ai për të ruajtur shuma të vonuara). Një vërtetim nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huadhënësit që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet dhe bazën e llogaritjes së tyre, kur i paraqiten Huamarrësit (përveç ndonjë gabimi të dukshëm) do të jenë prova përfundimtare të sasisë së këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe detyrimeve, me kusht që ky vërtetim të mbështetet nga dokumente që japin të dhëna për këto humbje, shpenzime dhe detyrime dhe këto vërtetime do të mbështeten nga dokumente të përshtatshme.

Huamarrësi, sapo të vihet në dijeni për këtë, do t'i japë njoftim me shkrim Huadhënësit për:

a) çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve; ose

b) çdo kusht, rast ose veprim që, me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, ose përmbushjen e ndonjë kushti, mund të çonte ose përbënte një rast të mosplotësimit të detyrimeve.

9. GARANCITË DHE ANGAZHIMET

9.1 Garancitë

Me qëllim inkurajimin e Huadhënësit për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të përfituar dhe mbajtur Huan e parashikuar në këtë Marrëveshje, Huamarrësi jep garancitë e mëposhtme në Datën e Pranimit:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veprojë në emër dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të vendosë Republikën e Shqipërisë para detyrimit ligjor. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Huamarrësi nuk është në mosplotësim të ndonjë prej detyrimeve të tij të pagesës dhe nuk ka ndodhur ose nuk po vazhdon asnjë Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve; ose

c) Huamarrësi ka autoritetin për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të marrë hua sipas saj dhe për të nënshkruar, dërguar dhe përmbushur këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të pranuar kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje, dhe për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje që përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në pajtim me kushtet e saj; ose

d) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nuk do të shkelë dispozitat e ndonjë ligji ose rregulloreje të zbatueshme për Huamarrësin ose ndonjë marrëveshjeje, kontrate ose angazhimi tjetër në të cilën Huamarrësi është palë ose që është detyruese për të ose asetet e tij; ose

e) Të gjitha autorizimet, miratimet, regjistrimet ose aprovimet (zyrtare ose të tjera), të nevojshme në lidhje me nënshkrimin, dorëzimin, përmbushjen, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

Garancitë e paraqitura më sipër do të vazhdojnë edhe pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të konsiderohen të përsëritura në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo Datë të Pagesës së Interesit.

9.2 Angazhimet

Huamarrësi merr përsipër dhe angazhohet me dhe për Huadhënësin si më poshtë:

a) Të dhënat:

Huamarrësi do të marrë masa:

1. Që: i) Blerësi i Projektit të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga Huaja; ii) Blerësi i Projektit informon në lidhje me përdorimin e tyre në Projekt; dhe iii) Blerësi i Projektit regjistron progresin e Projektit, duke përfshirë koston e tij;

2. Që përfaqësuesit e Huadhënësit të lejohen të inspektojnë Projektin, angazhimin e Blerësit të Projektit, mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokument tjetër;

3. Për të informuar Huadhënësin, ose të marrë masa që t'i dërgohet Huadhënësit i gjithë informacioni që

Huadhënësi kërkon në lidhje me shpenzimet e Huas, Projektin dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së Blerjes.

b) Njëvlershmëria dhe pengu negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* dhe njëlloj me të gjitha detyrimet e tjera të papaguara, të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga Data e Pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e Huas do të mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose bjerë dakord për të krijuar ndonjë hipotekë, detyrim, peng, barrë ose interes tjetër garancie mbi të gjithë ose një pjesë të aseteve të tij për të siguruar detyrime ose garanci të ndonjë detyrimi, nëse Huaja nuk sigurohet në mënyrë të barabartë dhe përpjesëtimore, të pranueshme për Huadhënësin.

c) Ndryshimi i Marrëveshjes së Blerjes

Huamarrësi nuk do të bëjë, lejojë ose miratojë ndonjë amendim, ndryshim, modifikim ose përfundim të (përveçse për prishjen e miratuar për shkak të një rezultati negativ të procesit të vlerësimit) Marrëveshjes së Blerjes, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMARRËVESHJET

a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin mbi këtë Marrëveshje, duke përfshirë lidhjen e saj, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen përfundimisht nga tre arbitra, sipas Rregullave të Pajtimimit dhe Arbitrazhit, në atë kohë në fuqi, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

c) Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha që do të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton përgjegjësinë e palëve për kostot e shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të kryer procedimet dhe për të përgatitur vendimin e tyre, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshëm sipas ligjit.

f) Gjykimi për vendimin mund të zhvillohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose në atë gjykatë mund të bëhet kërkesë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi merr masa ligjore (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestrimin, ekzekutimin ose masa të tjera zbatuese ose mbrojtëse) kundër Huamarrësit në lidhje me ndonjë çështje që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

Përrjashtimisht, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti mbi ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) “ambientet e tashme ose të ardhshme të misionit”, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, të nënshkruar më 1961, “ambientet e

tashme ose të ardhshme konsullore”, siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, të nënshkruar më 1963 ose të përdorur ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) çdo pasuri të paluajtshme që përmendet në nenin 3, paragrafët 1-3, të ligjit shqiptar nr. 8743, të datës 22.2.2001, “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”;

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë të kërkueshme në momentin e ekzekutimit, që është caktuar për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas të drejtës publike ndërkombëtare.

h) Huamarrësi e cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si personin e saj të kontaktit në Vjenë (aneksi 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, shkresat, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të jenë të vlefshme në rast njoftimi me shkrim me letër-rekomandë kur merret, ose në rast të njoftimit me faks, kur merret nga pala për të cilën ky njoftim, kjo shkresë, kërkesë ose komunikim tjetër kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në aneksin 1 ose në një adresë tjetër që njëri prej tyre mund të caktojë më pas me shkrim për tjetrin, në pajtim me këtë seksion 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përkufizojnë apo kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqjet dorë, mjetet mbrojtëse kumulative

Asnjë pamundësi ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë moment mirëkuptimi ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk operon si heqje dorë nga to; një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përjashtojë një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji tjetër. Të drejtat dhe mjetet ligjore në këtë marrëveshje të parashikuara shprehimisht janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive për ndonjë të drejtë ose mjet ligjor që Huadhënësi do të kishte ndryshe. Asnjë njoftim ose kërkesë ndaj Huamarrësit në ndonjë rast nuk autorizon Huamarrësin për njoftim ose kërkesë tjetër ose të mëtejshme në lidhje me të njëjtat rrethana ose nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e Huadhënësit për ndonjë veprim tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana, pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje çmohet nga një gjykatë ose organ tjetër kompetent

gjyqësor, si e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të saj nuk do të cenohet ose dëmtohet dhe palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rishikuar dispozitën e pavlefshme, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshme në pajtim me qëllimin e shprehur në të.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të caktojë ose të transferojë të gjithë ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje: i) pa pëlqimin e Huamarrësit, nëse drejtëmarrësi është OeKB-ja ose (në rast vetëm të Mosplotësimit të Detyrimeve) çdo bankë ose institucion tjetër financiar; dhe ii) me pëlqimin paraprak me shkrim të Huamarrësit, që nuk do të ndalohet në mënyrë të paarsyeshme të ndonjë përfitues tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Me anë të kësaj Marrëveshjeje Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të paraqitur në një mënyrë që është e zakonshme nga bankat, të gjithë informacionin që ai merr në lidhje me këtë marrëveshje ose marrëdhënien e tij të punës me Huamarrësin - veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve - për bankat, institucionet e përbashkëta të bankave ose organizatat e përzgjedhura për mbrojtjen e kreditorëve.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi bie më tej dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të dhënë informacion që rezulton nga kjo Marrëveshje ose nga marrëdhënia e punës së Huadhënësit me Huamarrësin për personat ose shoqëritë e mëposhtme:

- a) Çdo anëtar të grupit të shoqërive të Huadhënësit;
- b) Një përfitues i mundshëm që i transferohen të drejtat ose një personi apo shoqërie që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje;
- c) OeKB-në dhe Republikën e Austrisë; dhe
- d) Çdo person, autoritet ose subjekt tjetër për të cilin Huadhënësi i kërkohet të japë këtë informacion sipas ndonjë ligji ose urdhri gjyqësor ose organi rregullator, udhëzimet e të cilit duhet të përmbushen nga Huadhënësi.

11.7 Ndryshimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të modifikohet ose ndryshohet përveçse me instrumente me shkrim.

12. HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe miratimin nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botimin në gazetën zyrtare shqiptare të quajtur Fletore Zyrtare.

Në dëshmi të kësaj, palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më parë më sipër në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe versioni në gjuhën angleze do të jetë detyrues dhe do të ketë përparësi mbi përkthimet.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si
Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

UniCredit Bank Austria AG si Huadhënës

ANEKSI 1

PALËT

HUAMARRËSI

Emri: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së
Shqipërisë si Huamarrës
(përfaqësuar nga Ministria e Financave)

Adresa: Ministria e Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1

Tiranë/Shqipëri
Tel. (355 4) 222 84 94

Faks: (355 4) 222 84 05

HUADHËNËSI

Emri: UniCredit Bank Austria AG
Adresa: Schottengasse 6-8, 1010 Vienna
Tel. +43 (0)5 05 05-56914
Faks: +43 (0)5 05 05-5018

Departamenti përgjegjës
8067 Products & Portfolio Management
Në vëmendje të: Znj. Theresia Weymiers

ANEKSI 2

1. Projekti
"Shëndetësia Elektronike në Shqipëri - Regjistri
Mbarëkombëtar i Shëndetësisë Elektronike"

Projekti ndahet në fazën I dhe fazën II dhe mbaron pas fazës I, nëse Procesi i Vlerësimit del me rezultat negativ.

Faza I në shumën prej 7.483.000,00 euro që është Periudha e Vlerësimit, sipas përkrahimit në aneksin M të Marrëveshjes së Blerjes, gjatë së cilës dorëzimet bëhen nga Eksportuesi i Projektit sipas Marrëveshjes së Blerjes dhe që mbaron me përfundimin e Procesit të Vlerësimit të kryer nga OeKB-ja, sipas specifikimit në Garancinë e OeKB-së.

Faza II fillon në datën që Huadhënësi ka marrë konfirmim me shkrim nga OeKB-ja që Procesi i Vlerësimit ka sjellë rezultat pozitiv dhe mbaron me

përfundimin e të gjithë Projektit sipas përshkrimit në Marrëveshjen e Blerjes.

2. Marrëveshja e Blerjes

Një marrëveshje nr. ALB2012 Shëndetësia Elektronike, e datës 5 janar 2013, ndërmjet AME International GmbH ("Eksportuesi i Projektit") dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë ("Blerësi i Projektit") në shumën maksimale prej 13.995.000 eurosh (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) në lidhje me Projektin.

ANEKSI 3

1. Shuma e Kredisë (seksioni 2.2).

Një shumë që nuk kalon 13.995.000,00 euro (trembëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) ose në rast se OeKB-ja i konfirmon Huadhënësit që Procesi i Vlerësimit në lidhje me fazën I ka dalë me rezultat negativ, një shumë që nuk kalon 7.483.000,00 euro (shtatë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë).

2. Periudha e disponueshmërisë (seksioni 2.2)

Nga Data e Mbylljes (sipas përcaktimit në seksionin 7) deri në datën më të parë të disbursimit të 7.483.000,00 euro sipas kësaj Marrëveshjeje ose datën që OeKB-ja i konfirmon Huadhënësit se Procesi i Vlerësimit ka përfunduar,

gjithashtu, në rast se OeKB-ja i ka konfirmuar me shkrim Huadhënësit që Procesi i Vlerësimit ka dalë me rezultat pozitiv;

nga dita që OeKB-ja ia ka dhënë këtë informacion Huadhënësit deri në ditën që bie 21 muaj pas Datës së Mbylljes por që mbaron jo më vonë se (_____).

3. Interesi (seksioni 3.1)

0.00 për qind në vit

4. Kamatëvonesa (seksioni 3.3)

3 muaj EURIBOR plus një marzh prej 2% në vit

5. Tarifa e Angazhimit (seksioni 4.1)

0,5 % në vit (zero pikë pesë për qind në vit)

6. Tarifa e Menaxhimit (seksioni 4.2)

0,5 % (zero pikë pesë për qind) e pandryshueshme ndaj Shumës së Kredisë

7. Primi i Garancisë (seksioni 4.4)

i) Primi i Garancisë së OeKB-së që paguhet në fillim EUR 61,250.00

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare. Nëse shuma përfundimtare ndryshon nga shuma e treguar, Huamarrësi do të paguajë diferencën (nëse ka) brenda 30 ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar për të nga Huadhënësi.

ii) Primi i Garancisë së OeKB-së i pagueshëm si Marzh

1.00 për qind në vit

Sipas OeKB-së, norma e mësipërme mbështetet nga një grant shtesë që është afërsisht 1.020.633,33 euro

nga Ministria Federale Austriake e Financave. Norma dhe granti përfundimtar do të përcaktohen nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare.

8. Tarifa e administrimit të OeKB-së

1.440 euro në lidhje me Sigurimin e Kredisë së Eksportit.

9. Datat e detyrueshme të shlyerjes (seksioni 5.1)

Shlyerja duhet të realizohet deri në 19 këste të barabartë gjashtëmujore të njëpasnjëshëm, ku i pari është i kërkueshëm 72 muaj pas Datës së Përkohshme të Pranimit ose 93 muaj pas Datës së Mbylljes, në çdo rast jo më vonë se (_____).

10. Shuma Opsionale e Parapagimit (seksioni 5.2)

500,000 euro

11. Periudha e mbylljes (seksioni 7)

Një periudhë që fillon në Datën e Pranimit dhe jo më vonë se deri gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike pas Datës së Pranimit.

ANEKSI 4

PROCEDURA E PAGESËS

Huamarrësi autorizon Huadhënësin në mënyrë të përvokueshme që të paguajë Eksportuesin e Projektit deri në maksimumin e përgjithshëm të Shumës së Kredisë të përmendur në aneksin 3 kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme pranë Huadhënësit:

1. Paradhënia:

15% (pesëmbëdhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 2.099.250,00 euro (në fjalë, dy milionë e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) janë të pagueshme si paradhënie, menjëherë pas paraqitjes së:

- Faturës së parapagimit të Eksportuesit të Projektit në 3 (tri) kopje origjinale dhe 7 (shtatë) kopje;

- Kopje të Detyrimit të Performancës të lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 5% të Marrëveshjes së Blerjes;

- Kopje të Garancisë së Parapagimit të lëshuar nga një bankë austriake në një shumë prej 15% të Marrëveshjes së Blerjes.

2. Pagesa kundrejt dërgimit

80% (tetëdhjetë për qind) të shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 11.196.000,00 (në fjalë: njëmbëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) janë të pagueshme proporcionalisht në çdo dorëzim (do të lejohen dorëzime të pjesshme) pas paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:

A) Dokumentet e kërkuara në rastin e dorëzimit të pjesëve fizike dhe programeve

- Fatura Tregtare e Eksportuesit të Projektit në tri (3) kopje origjinale, të gjitha të nënshkruara rregullisht nga Eksportuesi i Projektit dhe tri (3) kopje.

- Certifikatë Sigurimi në një (1) kopje origjinale dhe tri (3) kopje.

- Lista e paketimit në një (1) kopje origjinale dhe tri (3) kopje.

- Kopje të International Truck Waybill (CMR), e vulosur dhe nënshkruar fillimisht nga transportuesi, e shënuar me “Ngarkesa e parapaguar” dhe numri i kontratës që tregon si marrës Blerësin e Projektit dhe/ose vendet e përmendura në aneksin K të Marrëveshjes së Blerjes.

dhe/ose

Kompletin e plotë të “On Board Ocean Bill of Landing” ose “FIATA Combined Bill of Landing”, në 3 (tri) kopje origjinale dhe tri (3) kopje të panegociueshme të bëra për porosinë, të sigluara, që njofton Blerësin e Projektit, duke treguar si port destinacioni çdo port detar në Shqipëri, duke treguar numrin e kontratës;

dhe/ose

Airway Bill në një (1) kopje origjinale dhe tri (3) kopje, që tregon si port shkarkimi një aeroport në Shqipëri, duke treguar ngarkesën e parapaguar, numrin e kontratës që tregon si marrës Blerësin e Projektit dhe/ose vendet e përmendura në aneksin K të Marrëveshjes së Blerjes.

B) Dokumentet e kërkuara në rastin e dorëzimit vetëm të programeve

- Fatura Tregtare e Eksportuesit të Projektit në tri (3) kopje origjinale, të gjitha të nënshkruara rregullisht nga Eksportuesi i Projektit dhe tri (3) kopje.

- Faturë e korrierit në një (1) kopje, drejtuar Blerësit të Projektit.

C) Dokumentet e kërkuara në rastin e dorëzimit vetëm të licencave të programeve

Fatura Tregtare e Eksportuesit të Projektit në tri (3) kopje origjinale, të gjitha të nënshkruara rregullisht nga Eksportuesi i Projektit dhe tri (3) kopje.

3. Pagesa përfundimtare kundrejt COHO-s

5% (pesë për qind) e shumës së Marrëveshjes së Blerjes që është 699.750,00 (në fjalë: gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) paguhen proporcionalisht në dorëzim (lejohen dorëzime të pjesshme) pas paraqitjes së:

- Faturës tregtare proporcionale të Eksportuesit të Projektit në 3 (tri) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;

- Tri (3) kopje të COHO-s përkatëse (Eksportuesi i Projektit lejohet të paraqesë më shumë se një COHO në një kohë).

Gjatë fazës I një shumë maksimale e plotë prej 7.483.000 eurosh (që përbëhet nga parapagesa në pajtim me artikullin 1) (Parapagesa) më sipër dhe pagesat e shumës së përgjithshme të plotë prej 5.383.750 eurosh në pajtim me artikullin 2) (pagesa kundrejt dërgimit) dhe artikulli 3) (pagesa përfundimtare kundrejt COHOs më sipër) do t'i paguhen Eksportuesit të Projektit.

Në rast se OeKB-ja i konfirmon Huadhënësit që Procesi i Vlerësimit në lidhje me fazën I ka dalë me rezultat pozitiv, Huadhënësi autorizohet të paguajë çdo shumë që nuk është paguar kundrejt dokumenteve të paraqitura gjatë fazës I dhe për më tepër të fillojë me disbursimet në lidhje me fazën II.

Në rast se OeKB-ja i konfirmon Huadhënësit që Procesi i Vlerësimit në lidhje me fazën I ka dalë me rezultat negativ, Huadhënësi nuk paguan asnjë shumë që kalon 7.483.000 eurosh -, pavarësisht nga vlera totale faktike e dokumenteve të paraqitura në fazën I.

Në fund të fazës I shuma e plotë e disbursuar prej 7.483.000 euro është e barabartë me vlerën e të gjitha furnizimeve që Eksportuesi duhet të bëjë gjatë fazës I, pavarësisht nga pagesa fillestare e pagesës paraprake në shumën prej 15% të vlerës së plotë të Projektit, për shkak të faktit që të gjitha disbursimet do të kreditohen kundrejt vlerës së furnizimeve gjatë fazës I (duke përfshirë një kompensim kundrejt shumave të paguara si parapagesë për fazën II) dhe Huadhënësi nuk do të paguajë asnjë pagesë që kalon 7.483.000 euro, pavarësisht nga vlera e përgjithshme faktike e dokumenteve të paraqitura gjatë fazës I.

Huadhënësi ka të drejtë të mbështetet në çdo dokument që besohet prej tyre që është i vërtetë dhe i saktë dhe të jetë nënshkruar ose dërguar nga personi i duhur. Huadhënësi nuk merr përgjegjësi apo detyrim për formën, njaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin ose efektin ligjor të një dokumenti(ëve), ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuar në dokument(e) ose të vendosura në to; ai nuk merr përgjegjësi ose detyrim as për përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, gjendjen, paketimin, dorëzimin, vlerën ose ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga një dokument(e), apo për mirëbesimin e veprimeve dhe/ose mosveprimeve, paafësinë paguese, përmbushjen ose gjendjen nga dërguesit, transportuesit, paraqitësit, marrësit ose siguruesit e mallrave dhe asnjë person tjetër të tillë.

Lejohen dërgimet e pjesshme dhe paraqitja e pjesshme e dokumenteve.

Huadhënësi i jep Huamarrësit njoftim me shkrim pasi t'i jetë kryer një Huamarrje Eksportuesit të Projektit.

Pas kryerjes së një Huamarrjeje për Eksportuesin e Projektit, Huadhënësi i dërgon dokumentet përkatëse Huadhënësit me shërbim të veçantë korrieri.

ANEKSI 5
OPINION LIGJOR
(Model)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë:

Për: UniCredit Bank Austria AG

Datë

Unë,, duke vepruar në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së Kredisë të Eksportit për një Hua të butë nr. 232,324 për një shumë prej 13.995.000 euro ("Marrëveshja") datë 2013 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi ("Huadhënës"). Unë nuk shpreh asnjë opinion në lidhje me ligjet e një juridiksioni të ndryshëm nga ai i Republikës së Shqipërisë.

Kam shqyrtuar kopjen e nënshkruar të Marrëveshjes dhe dokumente të tjera që i kam konsideruar të nevojshme dhe të përshtatshme, me qëllim që të mund të jap këtë opinion. Afatet e përcaktuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim, përveç kur Marrëveshja përcakton ndryshe.

Bazuar në sa më sipër, jam i mendimit që:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë është i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të Republikës së Shqipërisë dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Republikës së Shqipërisë. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Ndaj Republikës së Shqipërisë mund të ngrihet padi në emrin e saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Huamarrësit. Si pasojë, të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, ligjërisht detyruese dhe të zbatueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka autoritet të ngrejë padi dhe të paditet në emrin e tij.

c) Huamarrësi gëzon autoritetin për të lidhur / nënshkruar dhe realizuar Marrëveshjen. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (qeveritare dhe të tjera) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në të, si dhe ekzekutimin, shpalljen dhe realizimin e Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga Z. në cilësinë e tij si Ministër i Financave të Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit përbën detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin, të zbatueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në përputhje me afatet e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, të cilët nënshkruajnë apo vërtetojnë çdo dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen, kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të vepruar kështu në emër të Huamarrësit.

g) Nënshkrimi dhe realizimi i Marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuara në lidhje me të nuk janë në kundërshtim me: i) ligjet, rregulloret ose urdhrat zyrtare apo gjyqësore; ii) traktatet, marrëveshjet ose dokumente apo instrumente të tjera në të cilat Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë janë palë ose që janë detyruese mbi të apo mbi asetet e saj përkatëse.

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (përfshirë, nëse është e nevojshme, aprovimet e shkëmbimeve të kontrollit), miratimet, lejet, përjashtimet, të dhënat, regjistrimet, noterizimet dhe kërkesat e tjera të autoriteteve dhe institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike të nevojshme ose të rekomandueshme në lidhje me ekzekutimin, zbatimin, vlefshmërinë dhe realizimin e Marrëveshjes apo çdo pagese të realizuar sipas saj, janë lëshuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe Huamarrësi gëzon autoritetin e plotë për të kryer të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në euro (euro).

i) Të gjitha shumatat që do të paguheshin nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes, mund të realizohen të plota dhe pa zbritje për ose për sa u përket çdo tarife, takse, zbritjeje apo detyrimi nga Republika e Shqipërisë, çdo autoriteti tatimor apo nënndarjeje politike. Në rast të një ndalimi/zbritjeje për sa i përket pagesave të interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shumata shtesë sipas paragrafit 6.4 mbetet i vlefshëm dhe i zbatueshëm.

j) Kjo Marrëveshje është ratifikuar, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe është botuar në gazetën zyrtare shqiptare, që quhet Fletore Zyrtare dhe nuk është e nevojshme ose e këshillueshme të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria ose pranueshmëria si dëshmi të Marrëveshjes, në mënyrë që të arkivohet apo të regjistrohet pranë një autoriteti tjetër qeveritar ose agjencie në Republikën e Shqipërisë.

k) Zgjedhja e ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe zbatohet në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Hyrja në fuqi dhe përmbushja e Marrëveshjes nga Huamarrësi përbën veprim juridik privat dhe tregtar. Heqja dorë nga imuniteti në seksionin 10 (g) të Marrëveshjes është e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim që t'i mundësohet Huadhënësit të zbatojë të drejtat e tij përkatëse sipas Marrëveshjes; ose ii) për shkak të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet,

kualifikohet ose t'i jepet e drejta për të kryer veprimtari biznesi në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi as është, as do të jetë rezident, banues, as nuk do të kryejë veprimtari biznesi apo t'u nënshtrohet tatimeve në Republikën e Shqipërisë për shkak vetëm të nënshkrimit, shpalljes, përmbushjes dhe ekzekutimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e seksionit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë do të njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtar dhe do t'i zbatojnë këto vendime gjyqësore dhe/ose vendime arbitrazhi.

Një vendim i përcaktuar në euro (euro) do të njihet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

Sipas njohurive të mia, nuk ekziston asnjë procedim gjyqësor, arbitrazhi apo administrativ aktual apo i mbetur pezull ose, që sipas informacionit tonë, do të kryhej ndaj Huamarrësit, që do të kishte rezultuar ose mund të rezultonte në një ndryshim të pafavorshëm material në gjendjen financiare apo korporative të Huamarrësit.

n) Marrëveshja dhe të gjithë dokumentet e tjera nuk përmbajnë ndonjë dispozitë që do të konsiderohet e pazbatueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes do të renditen në çdo kohë të barasvlershme me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit, përveç atyre detyrimeve të parashikuara si të detyrueshme me ligj.

Ky opinion ligjor jepet vetëm në interes të Huadhënësit dhe nuk mund t'i bëhet i ditur ndonjë personi tjetër.

Me respekt,

ANEKSI 6

KONFIRMIM QË MARRËVESHJA E BLERJES ËSHTË NË FUQI DHE EFEKT TË PLOTË

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 232,324 për një shumë prej 13.995.000 eurosh ("Marrëveshja"), datë 2013 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi ("Huadhënës").

Të nderuar zotërinj,

Me anë të kësaj shkrese iu konfirmojmë se Marrëveshja e Blerjes nr. ALB2012, Shëndetësia Elektronike e lidhur më 5 janar 2013 ndërmjet AME International GmbH dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Shqipërisë ka hyrë në fuqi më (.....).

Vjenë,

.....
(Eksportues i Projektit)

ANEKSI 7 PRANIMI I EMËRIMIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT

(Huadhënësi)

Lënda: Marrëveshja e kredisë së eksportit për një hua të butë nr. 232,324 për një shumë prej 13.995.000 euro ("Marrëveshja") datë 2013 dhe e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë (përfaqësuar nga Ministria e Financave) si Huamarrës ("Huamarrës") dhe UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi ("Huadhënës").

Të nderuar zotërinj,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, pranoj në emrin tim dhe për llogari të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, emërimin si person i autorizuar i Huamarrësit për të shërbyer si person kontakti për dhe në lidhje me këtë Marrëveshje.

Adresa ime në Vjenë është:

Nëse do të ketë ndryshime në adresën time, do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Me respekt,

.....
Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Austri
vendit, data

VENDIM Nr. 496, datë 22.7.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE E TË PROCEDURAVE TË RINOVIMIT TË AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË DHËNA ME KONKURRIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 73, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**RREGULLAT DHE PROCEDURAT
E RINOVIMIT TË AUTORIZIMIT INDIVIDUAL
PËR PËRDORIMIN E FREKUENCAVE TË DHËNA
ME KONKURRIM**

**KREU I
KUSHTET LIGJORE PËR RINOVIMIN E
AUTORIZIMIT INDIVIDUAL**

1. Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave të dhëna nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) me konkurrim (ose tender) publik mund të rinovohet vetëm nëse në përfundim të afatit të vlefshmërisë së tij, nga mbajtësi i autorizimit individual për këto frekuenca (*sipërmarrësi*), janë përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të këtyre frekuencave të përcaktuara në autorizimin individual dhe ato të autorizimit të përgjithshëm në zbatim të përcaktimeve ligjore për këtë qëllim.

2. Për rinovimin e autorizimit individual para përfundimit të afatit të vlefshmërisë, sipërmarrësi duhet të paraqesi në AKEP, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, aplikimin për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit individual për përdorimin e frekuencave.

3. Aplikimi për rinovim i paraqitur nga sipërmarrësi shoqërohet me një informacion të sipërmarrësit mbi përmbushjen e kushteve të autorizimit individual sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

4. Nëse sipërmarrësi nuk paraqet në AKEP aplikimin për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit individual për përdorimin e frekuencave brenda afatit të parashikuar në nenin 73 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, AKEP-i i kërkon sipërmarrësit për t'u shprehur mbi gatishmërinë për rinovimin e autorizimit jo më vonë se 10 ditë nga skadimi i afatit sipas nenit 73.

**KREU II
APLIKIMI I SIPËRMARRËSIT DHE RAPORTI I
VLERËSIMIT TË AKEP**

1. Me marrjen e aplikimit për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë/rinovimin e autorizimit individual për

përdorimin e frekuencave nga sipërmarrësi, AKEP-i menjëherë fillon procedurën për vlerësimin e përmbushjes të të gjitha kushteve të përdorimit të këtyre frekuencave sipas autorizimit individual dhe atij të përgjithshëm, për:

a) Mbulimin e territorit dhe popullsisë me shërbim si dhe fortësinë e sinjalit (fuqinë e transmetimit);

b) Zbatimin e kushteve teknike të funksionimit, të nevojshme për shmangien e interferencave të dëmshme dhe kufizimin e ekspozimit të publikut ndaj fushave elektromagnetike;

c) Përdorimin dhe shfrytëzimin efektiv të frekuencave në përputhje me rregullat dhe standardet e përcaktuara, si dhe afatin e vlefshmërisë së përdorimit;

d) Cilësinë e shërbimit/ve dhe tarifat për shërbimet e ofruara nëpërmjet rrjetit që operon, sipas rregulloreve përkatëse të nxjerra nga AKEP-i;

e) Kryerjen e pagesave;

f) Transferimin e të drejtave të pronësisë për përdorimin e frekuencave dhe kushtet për këtë transferim;

g) Detyrime për aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë;

h) Detyrime të tjera, të marra përsipër nga sipërmarrësi gjatë pjesëmarrjes në tenderin/konkurrimin publik.

2. AKEP-i analizon, gjithashtu, investimet e kryera nga sipërmarrësi për shtrirjen dhe konfigurimin e rrjetit të ndërtuar për të operuar në frekuencën/brezin e frekuencave, gjendjen ekonomike dhe financiare, impaktin social dhe ekonomik të veprimtarisë së tij, që vërtetojnë se sipërmarrësi mbajtës i autorizimit ka kapacitetet për të vijuar përmbushjen e detyrimeve të autorizimit individual.

3. Gjithashtu, AKEP-i verifikon që rinovimi i autorizimit individual përjashton rrethanat e parashikuara në pikën 7 të nenit 67 të ligjit nr. 9918/2008.

4. Për kryerjen e vlerësimit të përmbushjes të të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave sipas autorizimit individual dhe atij të përgjithshëm, si dhe sa përcaktohet në pikat 2 dhe 3 më sipër, AKEP-i menjëherë me marrjen e aplikimit dhe informacionit nga sipërmarrësi për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit individual për përdorimin e frekuencave, mund t'i kërkojë me shkrim sipërmarrësit paraqitjen e informacionit plotësues, më të detajuar lidhur me përmbushjen e kushteve të përdorimit të këtyre frekuencave sipas përcaktimeve të parashikuara në pikën 1 më sipër, si dhe të dhëna të nevojshme në referencë me përcaktimet në pikat vijuese 2 (dy) dhe 3 (tre).

5. Sipërmarrësi aplikues, me marrjen e kërkesës së AKEP-it për informacion, sipas pikës 4 të këtij kreu, i kthen përgjigje AKEP-it brenda 10 (dhjetë) ditëve pune

nga data e marrjes së kërkesës, duke i vënë në dispozicion informacionin dhe të dhënat e kërkuara.

6. Me marrjen e informacionit dhe të dhënave nga sipërmarrësi, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e depozitimit të tij, AKEP-i, kryen vlerësimin e përmbushjes të të gjitha kushteve të përdorimit të këtyre frekuencave sipas autorizimit individual dhe atij të përgjithshëm, si dhe të dhënave të përcaktuara në pikat e mësipërme 1, 2 dhe 3, si dhe miraton raportin përmbledhës të vlerësimit të paraqitur nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim.

7. Menjëherë pas miratimit të raportit përmbledhës të vlerësimit, AKEP-i ia paraqet atë ministrit, duke i propozuar vijimin e procedurës sipas këtyre rregullave, nëse rezulton se sipërmarrësi aplikues i ka përmbushur të gjitha kushtet e përdorimit të këtyre frekuencave sipas Autorizimit Individual dhe atij të Përgjithshëm, si dhe nëse nuk ndodhet në kushtet e refuzimit të autorizimit individual.

8. Raporti përmbledhës i vlerësimit shoqërohet me një propozim mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e autorizimit individual. Ky propozim bazohet në parimin e objektivitetit, transparencës, jo diskriminimit dhe proporcionalitetit.

9. Propozimi i AKEP mbi çmimin referencë minimal merr në konsideratë praktikata e zbatuara në rajon dhe në vendet e Bashkimit Europian për procedurat e ngjashme.

10. AKEP-i në kriteret dhe metodologjitë e përcaktimit të çmimit referencë duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e konkurrencës, interesin publik dhe mbrojtjen e konsumatorit, rrethanat e tregut dhe përdorimin efektiv të frekuencave, si dhe mendimin paraprak të palëve të interesuara.

11. Propozimi për çmimin referencë minimal shoqërohet me argumentimin e AKEP-it për caktimin e tij.

KREU III PROCEDURA E NEGOCIMIT

1. Ministri, me marrjen e raportit të vlerësimit dhe propozimin mbi çmimin referencë minimal nga AKEP-i, në rrethanat që sipërmarrësi plotëson kushtet e parashikuara në kuadrin ligjor dhe atë rregullator për këtë qëllim, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e depozitimit të tij, urdhëron ngritjen e Komisionit *ad-hock* për Negocimin e Rinovimit të autorizimit individual (Komisioni i Negocimit).

2. Komisioni i negocimit drejtohet nga ministri përgjegjës për komunikimet elektronike dhe përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë, përfaqësues të ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

3. Nuk mund të marrin pjesë në Komisionin për Negocimin e Rinovimit të autorizimit individual, personat që përbëjnë konflikt interesi me sipërmarrësin aplikues, sipas kuptimit të ligjit “Për konfliktin e interesit”.

4. Çdo anëtar i Komisionit nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në urdhrin e ministrit për ngritjen e Komisionit të Negocimit përcaktohen tagrat e Komisionit, duke përfshirë përcaktimin e afatit të fillimit dhe përfundimit të periudhës së negocimit.

6. Komisioni fillon negocimin mbi bazën e çmimit minimal referencë të propozuar nga AKEP-i. Komisioni gjatë negocimit mban parasysh përmbushjen e objektivave të politikës së sektorit dhe programin e zhvillimit ekonomik të vendit.

7. Gjatë negocimit Komisioni i Negocimit mban parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore.

8. Palët në negocim përveç çmimit mund të negociojnë edhe për mënyrën e pagesës.

9. Komisioni i Negocimit mban procesverbal për të gjitha takimet e negocimit. Me përfundimin e negocimit palët nënshkruajnë aktin e dakordësisë në tre ekzemplare origjinale.

10. Ministri, mbi bazën e aktit të dakordësisë, brenda 3 (tri) ditëve nga data e depozitimit të tij nga Komisioni, njofton AKEP-in dhe sipërmarrësin aplikues për kryerjen e procedurave standarde sipas rregullores për autorizimin e përgjithshëm dhe atë individual të AKEP-it, për regjistrimin e njoftimit dhe pajisjen e sipërmarrësit me autorizimin individual për përdorimin e frekuencave të aplikuara sipas legjislacionit në fuqi.

11. Paga e rinovimit të autorizimit individual derdhet në buxhetin e shtetit.

KREU IV TË TJERA

1. Në mungesë të shprehjes së interesit nga mbajtësi i autorizimit individual, ose në rast të dështimit të negocimit për pagesën e rinovimit, AKEP-i ndjek procedurat e parashikuara sipas nenit 68 dhe 69 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për dhënien në përdorim të frekuencave.

2. AKEP-i në rastet kur procedura e rinovimit ka filluar brenda afateve ligjore, por nuk ka përfunduar para përfundimit të vlefshmërisë së autorizimit individual, si dhe në rastin e mungesës së aplikimit për rinovim brenda afatit ligjor, AKEP-i mund të marrë vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin 78 të Kodit të Procedurës Administrative për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit individual. Afati i shtyrjes në çdo rast nuk kapërcen afatin ligjor për vendimin e ndërmjetëm.

3. I gjithë procesi për fillimin e procedurës së rinovimit të autorizimit individual, rezultatet e vlerësimit së përmbushjes së detyrimeve dhe aktet e ministrit janë të hapura për publikun.

UDHËZIM

Nr. 3799, datë 8.7.2014

PËR NGRITJEN E AUTORITETIT PËRGJEGJËS PËR IDENTIFIKIMIN, REFERIMIN, MBROJTJEN DHE RIINTEGRIMIN E VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit".

UDHËZOJMË:

1. Ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave / viktimave të mundshme të trafikimit, këtej e tutje referuar si autoriteti përgjegjës.

2. Autoriteti përgjegjës të ketë këtë përbërje:

- a) Drejtori i Njësisë Antitrafik – kryetar
- b) 1 përfaqësues nga Sektori kundër Trafikeve të Paligjshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar
- c) 1 përfaqësues nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar
- d) 1 përfaqësues nga Sektori i Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të miturve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit – anëtar
- e) 1 përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror – anëtar
- f) 1 përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë – anëtar
- g) 1 përfaqësues nga Drejtoria Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme – anëtar
- h) 1 përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë – anëtar
- i) 1 përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit – anëtar
- j) Kryetari i KKSAT- anëtar

3. Autoriteti përgjegjës të udhëheqë zbatimin e Mekanizimit Kombëtar të Referimit lidhur me të gjitha rastet e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar dhe referuar në bazë të këtij mekanizmi në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit.

4. Autoriteti përgjegjës hedh të dhënat në Sistemin e Informacionit për Viktimat e Trafikimit (SIVET) sipas rubrikave përkatëse mbi çdo rast të identifikuar dhe referuar.

5. Autoriteti përgjegjës të mbliidhet në mënyrë periodike një herë në muaj, në varësi të rasteve të referuara.

6. Autoriteti përgjegjës t'i raportojë zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, njëkohësisht Koordinator Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në mënyrë periodike një herë në muaj, sipas nevojës për gjithë veprimtarinë e tij.

7. Të merren të gjitha masat për krijimin, plotësimin e infrastrukturës, logjistikës dhe financimit të nevojshëm, në drejtoritë përkatëse të këtyre institucioneve, për të trajtuar referimet e të gjitha viktimave të trafikimit, si dhe për të kryer të gjitha funksionet e tjera të bashkërendimit dhe raportimit, të cilat iu kërkohen sipas këtij udhëzimi.

8. Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik, përveç sa parashikohet në këtë udhëzim, mund të trajtojnë në mënyrë më të detajuar çështje të interesit të përbashkët nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta, që mund të lidhin për këtë qëllim.

9. Ngarkohet autoriteti përgjegjës të hartojë rregulloren e veprimit dhe të funksionimit të tij brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

10. Urdhri i përbashkët i ministrit të Brendshëm nr. 3394/4, datë 17.5.2006, i ministrit të Punëve të Jashtme nr. 7590, datë 24.5.2006 dhe i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr. 1152, datë 19.5.2006, "Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave të trafikimit dhe përcaktimin e detyrave të institucioneve të përfshira në këtë proces", shfuqizohet.

11. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe autoriteti përgjegjës, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Erion Veliaj

VENDIM
Nr. 31, datë 30.4.2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN,
ORGANIZIMIN, VEPRIMTARINË DHE
MBIKËQYRJEN E ZYRAVE TË KËMBIMIT
VALUTOR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” dhe shkronjës “a” të nenit 61 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 31, datë 6.6.2007, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

a) Përmbajtja e nenit 3 ndryshon si më poshtë:

i) në pikën 3 të shkronjës “e”, shtohet togfjalëshi “dhe adresa e zyrave ku ushtron veprimtarinë/të, përfshirë dhe adresën/at elektronike”, dhe pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtje si më poshtë:

“emrat e aksionerëve ose ortakëve të zyrës.”;

ii) në pikën 4 të shkronjës “f”, shtohet togfjalëshi “(nëse aplikohet)”;

iii) shkronja “j” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“agjent” - është personi juridik, i cili merr përsipër të drejtat dhe detyrimet për ushtrimin e veprimtarisë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, të përcaktuara në kontratën përkatëse të agjencisë me subjektin financiar jobankë, sipas parashikimeve të bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe kërkesave të kësaj rregulloreje”.

b) Kudo në nenin 5, përpara togfjalëshit “transferimit të parave” shtohet togfjalëshi “shërbimeve të pagesave dhe të”.

c) Fjalja e fundit e shkronjës “j” të nenit 6, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“Dokumenti i kërkuar sipas kësaj shkronje, duhet të përmbajë të paktën informacion për mjediset dhe kushtet e sigurisë të përcaktuara në aneksin nr. 7 bashkëlidhur kësaj rregulloreje”.

d) Në shkronjën “a” të nenit 7, pas togfjalëshit “veprimtaria e agjentit për”, shtohet togfjalëshi “kryerjen e shërbimeve të pagesave dhe të”, si dhe pas shkronjës “c” të këtij neni, shtohet shkronja “d” me përmbajtje si më poshtë:

“informacion mbi mënyrën e regjistrimit dhe ruajtjes në një regjistër të posaçëm të të gjitha transaksioneve të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave që kryen në emër dhe për llogari të subjektit financiar jobankë.”

e) Në nenin 8, pika 2, përpara togfjalëshit “transferimit të parave” shtohet togfjalëshi “kryerjen e shërbimeve të pagesave dhe të”.

f) Kudo në nenin 14, përpara togfjalëshit “transferimit të parave”, shtohet togfjalëshi “shërbimeve të pagesave dhe të”.

g) Në shkronjën “b” të nenit 16, pas togfjalëshit “kursët e këmbimit” shtohet togfjalëshi “dhe komisionet (nëse aplikohen)”, si dhe pas germës “d” të këtij neni, shtohet germa “e” me përmbajtje si më poshtë:

“informuar klientin përpara kryerjes së transaksionit, në rast të aplikimit të komisioneve, nëpërmjet “Deklaratës për njohjen paraprake me komisionin e aplikuar”, të përcaktuar në aneksin nr. 8 bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Subjekti e ruan deklaratën, jo më pak se një muaj pas nënshkrimit të saj nga klienti.”;

h) Në shkronjën “d” të nenit 20, përpara togfjalëshit “dhe të transfertave të parave”, shtohet togfjalëshi “të shërbimeve të pagesave”, si dhe pas shkronjës “h” të këtij neni, shtohen shkronjat “i” dhe “j” me përmbajtje si më poshtë:

“i) subjekti nuk informon klientin nëpërmjet “Deklaratës për njohjen paraprake me komisionin e aplikuar”, sipas shkronjës “e” të nenit 16 të kësaj rregulloreje;

j) kambisti ushtron veprimtarinë e këmbimit valutor jashtë ambienteve të zyrës së këmbimit valutor.”

i) Në shkronjën “b”, të nenit 24 hiqet togfjalëshi “shkronjat “a” deri “e””.

j) Në aneksin 1 të rregullores shtohet pika 10 me përmbajtjen e mëposhtme:

“adresën/at elektronike të zyrës së këmbimit valutor”.

k) Aneksi 6 i rregullores, ndryshon sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe pas aneksit 6 të rregullores, shtohen anekset 7 dhe 8 sipas anekseve 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ardian Fullani

Aneksi 1 (i vendimit)

ANEKSI NR. 6
INFORMACION MBI PAJISJET TEKNIKO-ADMINISTRATIVE

Zyra e këmbimit valutor, e vendosur në adresën....., ka krijuar kushtet tekniko-administrative për realizimin e aktivitetit të këmbimit valutor.

Pajisjet tekniko-administrative, që disponon zyra për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

<i>Lloji i pajisjes</i>	<i>Disponueshmëria e pajisjes</i>
• <i>Kompjuter, printer dhe/ose aksesorët e tyre</i>	√
• <i>Fotokopje dhe/ose skaner</i>	√
• <i>Mjete komunikimi (telefon dhe/ose faks, e-mail)</i>	√
• <i>Makinë të numërimit dhe të verifikimit të parave</i>	√
• <i>Tabelë e shfaqjes për publikun të kursit të këmbimit dhe të komisioneve (nëse aplikohen)</i>	√
• <i>Faturë tip për veprimet në sportel</i>	√
• <i>Tabelë e jashtme e shoqëruar me emërtimin ligjor të zyrës</i>	√

Informacioni i kërkuar sipas nenit 6, pika 1, shkronja "i" të kësaj rregulloreje, mund të shtohet edhe për pajisjet shitesë që zyra disponon, të cilat e ndihmojnë (zyrën) në ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor dhe/ose të veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, në rastet e parashikuara dhe të lejuara nga kjo rregullore.

Datë _____

Me respekt,

Z/znj. _____

Administrator/e i/e shoqërisë " _____ " sh.p.k./sh.a.

(nënshkrim/firmë, vulë)

Aneksi 2 (i vendimit)

ANEKSI NR. 7
INFORMACION MBI MJEDISET DHE KUSHTET E SIGURISË

Zyra e këmbimit valutor, e vendosur në adresën....., ka krijuar kushtet e sigurisë për realizimin e aktivitetit të këmbimit valutor, siç paraqiten në tabelën e mëposhtme:

<i>Kushtet</i>	<i>Disponueshmëria</i>
• Zyra ka hapësira të nevojshme dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe vlerave monetare	√
• Zyra ka qartësisht të ndarë zonën e pritjes së klientit nga zona e arkëtarëve	√
• Zona e arkëtarëve kufizohet nga zonat e tjera me sportel	√
• Vlerat monetare mbahen në kasafortë	√
• Zyra monitorohet me telekamera	√
• Telekamerat filmojnë në mënyrë të pandërprerë	√
• Zyra ka pajisje digjitale për regjistrimin e pamjeve	√

Informacioni i kërkuar sipas nenit 6, pika 1, shkronja "j" të kësaj rregulloreje, mund të shtohet edhe për pajisjet shitesë që zyra disponon, të cilat e ndihmojnë (zyrën) në ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor dhe/ose të veprimtarisë së shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave, në rastet e parashikuara dhe të lejuara nga kjo rregullore.

Datë _____

Me respekt,

Z/znj. _____

Administrator/e i/e shoqërisë _____

(nënshkrim)

Aneksi 3 (i vendimit)

**ANEKSI NR. 8
DEKLARATË PËR NJOHJEN PARAPRAKE ME KOMISIONIN E APLIKUAR**

Deklaroj se u informova paraprakisht mbi aplikimin e komisionit në transaksionin e mëposhtëm:

Transaksioni: Këmbim nga _____ në _____
(monedha) (monedha)

1. *Kursi i këmbimit* _____
2. *Shuma për t'u këmbyer* _____
3. *Shuma pas konvertimit* _____
4. *Komisioni që mbahet (%)* _____
5. *Komisioni që mbahet (në vlerë)* _____
6. *SHUMA FINALE që përfiton klienti* _____

Data e kryerjes së transaksionit _____

Nënshkrimi i klientit

(emër, mbiemër, firmë)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 28 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006